

## PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligji “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Kryeministria
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Finale
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Direktiva / Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Projektligji nuk është i lidhur me publikime apo strategji.
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	15.06.2022 - 13.07.2022
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	19/07/2022
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	Po 05/06/2022
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	2022 – Kryeministria – 1
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	Vangelt Duni <a href="mailto:vangelt.duni@kryeministria.al">vangelt.duni@kryeministria.al</a> , 0695601625
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
<b>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</b>	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	
<p>Nisma e ndërmarrë për hartimin e këtij projektligji ka ardhur për shkak të nevojës së reformimit të sistemit të dekoratave dhe procedurës së ndjekur për shqyrtimin e propozimeve për dekorim dhe dhënies së dekoratave në Republikën e Shqipërisë duke synuar unifikimin dhe konsolidimin e procedurës dhe praktikës që ndiqet në këtë drejtim përmes kryerjes së këtij procesi nga Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve, institucion ky i parashikuar në këtë projektligj për shqyrtimin e dosjeve të kandidaturave të propozuara për dekorim dhe verifikimin e elementëve formalë dhe kriterëve materiale që duhet të përmbushen nga subjektet përkatëse për dhënien e dekoratës së propozuar.</p> <p>Projektligji paraqet risi në drejtim të strukturimit të tij në dallim nga ligji nr. 112/2013 i sipërcituar, pasi trajton vetëm çështjet që lidhen me sistemin e dekoratave dhe procedurës që ndiqet për dhënien e tyre, duke lënë mënjanë titujt e nderit të cilat meritojnë trajtim të posaçëm në një akt ligjor më vete, referuar edhe modeleve të vendeve evropiane përfshirë këtu modelin italian dhe francez.</p> <p>Në dallim nga ligji nr. 112/2013, projektligji parashikon një sistem të ri të dekoratave që jepen në Republikën e Shqipërisë dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre sipas një procedure të mirëpërcaktuar në ligj. Sipas këtij projektligji, autoritetet që mund të japin dekorata janë Presidenti</p>	

i Republikës nëpërmjet dekretit, si dhe Kryeministri, ministri përgjegjës për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, me urdhër.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)*

Objektivi kryesor i këtij projektligji është krijimi dhe mirëorganizimi i sistemit të dekoratave në Republikën e Shqipërisë, që jepen si shenjë mirënjohjeje ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj për kontributin e dhënë dhe meritat e shquara apo të veçanta, civile ose ushtarake, ndaj shtetit dhe kombit shqiptar.

Nëpërmjet këtij projektligji, synohet krijimi i një praktike të konsoliduar në drejtim të procedurave që ndiqen për dhënien e dekoratave, përmes unifikimit të proceseve që lidhen me verifikimin e kriteve dhe elementëve formalë dhe materiale që kërkohen në ligj për dhënien e dekoratave subjekteve përkatëse nga një organ i specializuar i ngritur me ligj për këtë qëllim, e cila i shërben dhënies së dekoratave në përputhje me parimin e vlerësimit të kontributit dhe meritokracisë.

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Opsioni 1 - Mosndryshimi i ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Opsioni 2 - Kryerja e ndryshimeve në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Opsioni 3 - Hartimi i një ligji të ri për dekoratat në Republikën e Shqipërisë.

Në raport me dy opsionet e tjera, opsioni 3 është vlerësuar nga ana jonë si opsioni më i përshtatshëm referuar objektivave që synohen të arrihen në këtë rast që konsistojnë në përmirësimin e organizimit të sistemit të dekoratave të Republikën e Shqipërisë, si dhe në unifikimin e procedurave që ndiqen për dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Këto objektiva të parashtruara në nivel makro nuk mund të arrihen nëpërmjet ruajtjes së *status quo*-së, pasi është e nevojshme ndërhyrja ligjore dhe as nëpërmjet opsionit 2, për shkak të ndryshimeve dhe risive që parashikon projektligji në raport me ligjin nr. 112/2013 që është në fuqi aktualisht.

## **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasimore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)*

Në aspektin financiar, nisma në fjalë paraqet ndikim financiar vetëm në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medalje, i cili paraqitet si një organ i ngritur vetëm në nivel qendror, me seli në Tiranë. Struktura dhe organika e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve parashikohet të miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislationit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Ky efekt i përafërt, për një numër prej 10 nëpunësish, parashikohet të jetë i ndarë në zërat buxhetorë të mëposhtëm:

Paga dhe sigurime shoqërore për një vit, në vlerën rreth 13.500.000 lekë;  
Investime, në vlerën rreth 3.900.000 lekë;  
Shpenzime etj, në vlerën prej 24.000.000 lekë.

Në aspekt të krijimit dhe prodhimit të dekoratave, projektligji nuk parashikohet të ketë efekte financiare shtesë, duke patur parasysh se fondet për këtë qëllim janë të përfshira në buxhetin që është miratuar në kuadër të ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të ligjit 9/2015 “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

#### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opcionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Pas shqyrtimit të alternativave, opsioni i preferuar përzgjidhet opsioni 3, krijimi i një ligji të ri që ka për qëllim krijimin dhe organizimin e sistemit të dekoratave në Republikën e Shqipërisë, që jepen si shenjë mirënjohjeje ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj për kontributin e dhënë dhe meritat e shquara apo të veçanta, civile ose ushtarake, ndaj shtetit dhe kombit shqiptar.

**Kostoja e përlogaritur në total e opcionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

<b>Viti <u>1</u></b>	<b>Viti <u>2</u></b>	<b>Viti <u>3</u></b>
0	0	0

#### **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)*

Projektligji “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë” u publikua në datë 15.6.2022 në RENJK në linkun [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al). Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik. Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 13.7.2022. Nuk pati asnjë koment apo sugjerim lidhur me projektligjin “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, të publikuar në RENJK.

#### **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)*

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, Këshilli i Ministrave ngarkohet që të miratojë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji, brenda 6 (gjashtë) muajve. Monitorimi në nivel makro do të realizohet nga struktura përkatëse përgjegjëse në Kryeministri. Kontrolli për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore që nxirren në bazë dhe në zbatim të tij parashikohet të ushtrohet nga subjektet sipas detyrave, të drejtave dhe përgjegjësisë të përcaktuara në legjisllacionin e ri.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

## **Historik**

*Jepni kontekstin e politikës.*

Aktualisht, sistemi i dekoratave gjen rregullim në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 10/2015, datë 19.2.2015. Ky ligj, sikurse përcaktohet që në emërtimin e tij, përcakton rregulla edhe për titujt e nderit, procedurën e dhënies së tyre, autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre, llojet e titujve të nderit, e të tjerë. Në projektligjin në fjalë është vlerësuar përcaktimi i rregullave për sistemin e dekoratave në Republikën e Shqipërisë dhe rregullimi me ligj tjetër të veçantë të titujve të nderit, duke mbajtur në konsideratë rregullimet ligjore të vendeve evropiane, kryesisht modelin italian dhe francez.

Gjithashtu, synohet rregullimi në këtë projektligj edhe i dekoratave që u jepet personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe ushtarakëve të huaj, sipas rastit, çështje të cilat aktualisht gjejnë rregullim në ligjin nr. 9/2015 “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në këtë drejtim, kemi të bëjmë edhe me një riorganizim ligjor të rregullimeve që lidhen me sistemin e dekoratave që synon konsolidimin e legjislationit në fushën e dekoratave në Republikën e Shqipërisë, duke i shërbyer edhe koherencës së përcaktimeve ligjore.

Referuar në sa më sipër, në kushtet edhe kur projektligji në fjalë përmban risi në mënyrën e dhënies së dekoratave, përcaktimin e llojeve të tyre si dhe autoriteteve përgjegjëse për shqyrtimin dhe dhënien e dekoratave, është vlerësuar hartimi i një projektligji të ri, i cili shfuqizon ligjin nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr.9/2015 “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që bien në kundërshtim me këtë projektligj.

### **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Sikurse është parashtruar edhe më sipër, projektligji paraqet risi në shumë drejtime që lidhen me çështjet e llojeve të dekoratave, autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre si dhe procedura që ndiqet për dhënien e tyre, në raport me ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 112/2013).

Konkretisht, ligji nr. 112/2013 nuk ka pasur të përcaktuar në mënyrë të qartë subjektet të cilëve u jepen dekoratave sipas kushteve dhe kriterëve ligjore, duke përmendur vetëm termat “personalitete shqiptare” apo personalitete të huaja”. Në projektligj janë përcaktuar subjektet përfitues, të cilët mund të jenë shtetasit shqiptarë ose të huaj, personat juridikë, privatë ose publikë, forcat, shërbimet ose njësitë ushtarake, si dhe shërbimet ose njësitë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

Sa i takon llojeve të dekoratave, në projektligj i është kushtuar rëndësi e veçantë ndarjes dhe zbërthimit specifik të secilit prej tyre duke përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet për përfitimin e tyre,

përbërjen e dekoratave dhe rregullat për dhënien e tyre, në dallim nga ligji nr. 112/2013 i cili ndalet vetëm në përkufizimin e tyre, pa u ndalur në përcaktimin e rregullave materiale në lidhje me dhënien e tyre.

Sa i takon autoriteteve përgjegjëse për dhënien e tyre, në dallim nga ligji nr. 112/2013 i cili përcakton në këtë cilësi Presidentin e Republikës, Kuvendin, Kryeministrin, ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike si dhe ministrat e tjerë, në projektligj parashikohet dhënia e dekoratave nga Presidenti i Republikës nëpërmjet dekretit, si dhe nga Kryeministri, ministri përgjegjës për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, me urdhër.

Me qëllim shmangien e abuzimeve në ushtrimin e funksionit të dhënies së dekoratave sipas ligjit, në projektligj parashikohet edhe numri vjetor i dekorimeve, që mund të jepen për secilën shkallë të urdhrave. Ndërkohë, për medaljet është parashikuar se numri vjetor i tyre është i pakufizuar, me përjashtim të rasteve kur vetë projektligji parashikon ndryshe.

Ligji nr. 112/2013 ka qenë jo i plotë në drejtim të rregullimit të rasteve kur u hiqet dekoratave subjekteve që e kanë marrë atë sipas ligjit. Në projektligjin e ri janë përcaktuar këto raste në mënyrë shteruese, të cilat përmbajnë rrethana të atilla që e bëjnë të pamundur objektivisht mbajtjen e dekoratës, referuar edhe qëllimit për të cilin jepet.

Në dallim nga ligji nr. 112/2013, i cili parashikonte krijimin e komisioneve këshillimore pranë çdo autoriteti për dhënien e dekoratave, i cili jep mendimin e tij për dhënien e dekoratës, duke verifikuar nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementët e kërkuara nga ligji, dhe më pas vendimmarrja për miratimin ose jo të propozimit i takon autoritetit përgjegjës për dhënien e saj, projektligji i ri parashikon ngritjen e një organi në nivel qendror që financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, konkretisht të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve, e cila ka në përbërje dy organe drejtuese: Kancelarin dhe Kolegjin e Urdhrave dhe Medaljeve. Ky i fundit ka në kompetencë të tij verifikimin e meritave dhe cilësive morale të subjekteve që propozohen për dekorim në Republikën e Shqipërisë, përmes shqyrtimit të të gjitha dosjeve të kandidaturave për dekorim që përcillen nga autoritetet propozuese përkatëse, duke përfshirë edhe rastet kur nisma për dhënien e dekoratës ndërmerret kryesisht nga autoriteti përgjegjës për dhënien e tyre.

Shqyrtimi i të gjitha dosjeve të kandidaturave të propozuara për dekorim nga Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve, sipas procedurës që gjen rregullim në këtë projektligj, i shërben unifikimit dhe konsolidimit të praktikës që ndiqet për dhënien e dekoratave, sa i takon verifikimit të kritereve dhe elementëve ligjore, meritave dhe cilësive morale të kandidaturave të propozuara për dekorim, si dhe shmangies së abuzimit në dhënien e dekoratave nga autoritetet përgjegjëse pa meritokraci, duke filluar që nga krijimi i komisioneve këshillimore pranë tyre me përbërje shumice nga punonjës nën varësinë e tyre.

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Për zgjidhjen efektive dhe adresimin e problematikave, si dhe përmbushjen reale të objektivave shfaqet e nevojshme hartimi i një projektligji të ri për sistemin e dekoratave në Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar rregulla të qarta për llojet e dekoratave që jepen në Republikën e Shqipërisë, si dhe procedurave dhe kritereve për propozimin, shqyrtimin dhe dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse dhe mbajtjen e tyre publike.

## **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi kryesor i këtij projektligji është krijimi dhe mirëorganizimi i sistemit të dekoratave në Republikën e Shqipërisë, që jepen si shenjë mirënjohjeje ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj për kontributin e dhënë dhe meritat e shquara apo të veçanta, civile ose ushtarake, ndaj shtetit dhe kombit shqiptar.

Nëpërmjet këtij projektligji, synohet krijimi i një praktike të konsoliduar në drejtim të procedurave që ndiqen për dhënien e dekoratave, përmes unifikimit të proceseve që lidhen me verifikimin e kriterëve dhe elementëve formalë dhe materiale që kërkohen në ligj për dhënien e dekoratave subjekteve përkatëse, nga një organ i specializuar në këtë drejtim, e cila i shërben dhënies së dekoratave në përputhje me parimin e vlerësimit të kontributit dhe meritokracisë.

## **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 1 - Mosndryshimi i ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Opsioni 2 - Kryerja e ndryshimeve në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Opsioni 3 - Hartimi i një ligji të ri për dekoratat në Republikën e Shqipërisë.

Në raport me dy opsionet e tjera, opsioni 3 është vlerësuar nga ana jonë si opsioni më i përshtatshëm referuar objektivave që synohen të arrihen në këtë rast që konsistojnë në përmirësimin e organizimit të sistemit të dekoratave të Republikën e Shqipërisë, si dhe në unifikimin e procedurave që ndiqen për dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Këto objektiva të parashtruara në nivel makro nuk mund të arrihen nëpërmjet ruajtjes së *status quo*-së, pasi është e nevojshme ndërhyrja ligjore dhe as nëpërmjet opsionit 2, për shkak të ndryshimeve dhe risive që parashikon projektligji në raport me ligjin nr. 112/2013 që është në fuqi aktualisht.

## **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*

- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbli dhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Sikurse mund të konstatohet nga seksioni i mësipërm, zgjedhja e cilitdo prej opsioneve, veç opsionit 3, nuk do të mundësonte përmbushjen me sukses të objektivave. Më konkretisht, po paraqesim më poshtë avantazhet dhe disavantazhet, direkte apo indirekte, të këtij opsioni.

### ***1. Avantazhet:***

#### *Direkte*

##### *i. Ekonomike*

- Për subjektet që do t'i jepen dekorata, dhënia e këtyre të fundit nuk do të shoqërohet me një shpërblim financiar në dallim nga legjislacioni aktual në fuqi, duke mos rënduar buxhetin e shtetit në këtë drejtim.

##### *ii. Sociale*

Ndër ndikimet sociale direkte mund të listojmë:

- shtimin e motivimit dhe frymëzimit për kryerjen e veprimeve me vlerë e meritë për përparimin e shoqërisë dhe kombit;
- lartësimi i vlerës së dekoratave të shpërndara;
- ruajtjen e imazhit të vendit nga zhvlerësimi i mëtejshëm për shkak të abuzimit me dhënien e dekoratave, që nënkupton një avantazh të madh social, ekonomik (indirekt), duke justifikuar plotësisht ndërmarrjen e kësaj nisme.

#### *Indirekte*

##### *i. Sociale*

Forcimi i unitetit shoqëror dhe i respektit për kontribuesit në përparimin e shoqërisë dhe kombit mund të evidentohet si një ndikim social indirekt i kësaj politike.

### ***2. Disavantazhet:***

#### *Direkte*

##### *i. Ekonomike*

Për subjektet që do t'i jepen dekorata, dhënia e këtyre të fundit nuk do të shoqërohet me një shpërblim financiar në dallim nga legjislacioni aktual në fuqi.

## Indirekte

### i. Sociale

Disavantazhi, që mund të krijojë projektligji lidhet me subjektet të cilëve më parë i janë dhënë dekorata dhe të cilët dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, ose janë shpallur “person i padëshiruar”, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt në Republikën e Shqipërisë.

Në aspektin financiar, nisma në fjalë paraqet ndikim financiar vetëm në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medalje, i cili paraqitet si një organ i ngritur vetëm në nivel qendror, me seli në Tiranë. Struktura dhe organika e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve parashikohet të miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Ky efekt i përafërt, për një numër prej 10 nëpunësish, parashikohet të jetë i ndarë në zërat buxhetorë të mëposhtëm:

Paga dhe sigurime shoqërore për një vit, në vlerën rreth 13.500.000 lekë;

Investime, në vlerën rreth 3.900.000 lekë;

Shpenzime etj, në vlerën prej 24.000.000 lekë.

Në aspekt të krijimit dhe prodhimit të dekoratave, projektligji nuk parashikohet të ketë efekte financiare shtesë, duke patur parasysh se fondet për këtë qëllim janë të përfshira në buxhetin që është miratuar në kuadër të ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të ligjit 9/2015 “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

### **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 3 është vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm referuar objektivave që synohen të arrihen në këtë rast që konsistojnë në përmirësimin e organizimit të sistemit të dekoratave të Republikën e Shqipërisë, si dhe në unifikimin e procedurave që ndiqen për dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Këto objektiva të parashtruara në nivel makro nuk mund të arrihen nëpërmjet ruajtjes së status quo-së, pasi është e nevojshme ndërhyrja ligjore dhe as nëpërmjet opsionit 2, për shkak të ndryshimeve dhe risive që parashikon projektligji në raport me ligjin nr. 112/2013 që është në fuqi aktualisht.

Projektligji “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë” ka për qëllim krijimin dhe organizimin e sistemit të dekoratave në Republikën e Shqipërisë, që jepen si shenjë mirënjohjeje ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj për kontributin e dhënë dhe meritat e shquara apo të veçanta, civile ose ushtarake, ndaj shtetit dhe kombit shqiptar. Ky projektligj vendos rregulla të cilat përcaktojnë llojet e dekoratave që jepen në Republikën e Shqipërisë, si dhe procedurat dhe kriteret për propozimin, shqyrtimin dhe dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse dhe mbajtjen e tyre publike.

Ndërhyrja me një akt ligjor të ri paraqitet i domosdoshëm në kushtet kur synohet rregullimi në këtë projektligj i të gjitha llojeve të dekoratave që jepen në Republikën e Shqipërisë, përfshirë këtu edhe dekoratat që u jepen personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë apo ushtarakëve të huaj, të cilat aktualisht gjejnë rregullim në ligjin nr. 9/2015 “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Në këtë drejtim, është synuar rregullimi



ligjor i sistemit të dekoratave në një akt ligjor të vetëm, duke unifikuar edhe rregullat procedurale që ndiqen për shqyrtimin e propozimeve për dekorim dhe dhënien e tyre subjekteve përkatëse nga autoritetet përgjegjëse.

Në kushtet kur projektligji synon të rregullojë vetëm sistemin e dekoratave, në dallim nga ligji nr. nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 10/2015, datë 19.2.2015, atëherë paralelisht me këtë projektligj është hartuar edhe projektligji që do të rregullojë titujt e nderit, me qëllim eliminimin e vakumit ligjor në eventualitetin e hyrjes në fuqi të këtij projektligji.

### **Çështje të zbatimit**

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Strukturat përgjegjëse për zbatimin janë: Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve, me dy organet e saj përbërëse përkatësisht Kancelari dhe Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve, autoritetet përgjegjëse për dhënien e dekoratave të listuara në nenin 6 (Presidenti, Kryeministri, ministri përgjegjës për Forcat e Armatosura, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike), si dhe autoritetet që kanë të drejtën e propozimit të tyre, të listuara në nenin 32 (Kryetari i Kuvendit; Kryeministri; Këshilli i Lartë Gjyqësor; Këshilli i Lartë i Prokurorisë; Kryetari i Akademisë së Shkencave; Rektorët e institucioneve publike të arsimit të lartë; Krerët e bashkësive fetare të njohura nga ligji; dhe Njësitë e vetëqeverisjes vendore.)

Për sa i përket pengesave të mundshme në zbatim, vlerësojmë se për nga natyra, objekti dhe përmbajtja e legjislacionit të propozuar nuk ka pengesa të karakterit substancial që të parandalojnë përmbushjen e objektivave të nismës. Ajo cka mund të themi lidhur me këtë, është se pengesa eventuale mund të lidhet potencialisht me keqinterpretimin dhe keqzbatimin nga autoritetet përgjegjëse të dispozitave të këtij projektligji, duke deformuar frymën dhe qëllimin e tij.

Më tej, lidhur me masat që do të merren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës, sqarojmë se për të mundësuar zbatimin e projektligjit është i nevojshëm miratimi i një sërë akteve nënligjore që përcaktojnë kriteret specifike për dhënien e secilës dekoratë dhe medalje. Janë pikërisht këto kriteret që përbëjnë parakushtin për përmbushjen e objektivit të politikës dhe përputhshmërinë e zbatimit me këtë politikë. Gjithashtu, theksojmë se rol të rëndësishëm për mundësimin e zbatimit të objektivave do të luajë edhe miratimi i Rregullores së Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve me Vendim të Këshillit të Ministrave (sic parashikohet në nenin 26, pika 4). Kjo rregullore do të përmbajë rregullat e detajuara të funksionimit të Kancelarisë, të cilat janë premisë themelore për realizimin konkret të misionit dhe detyrave që ky organ ka sipas projektligjit.

### **Faza e monitorimit dhe vlerësimit**

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Duke qenë se Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve, përveç aspektit të mirëfilltë zbatues të veprimtarisë, si element kryesor të përgjegjësisë së saj ka verifikimin e plotësisht të kushteve dhe kriterëve për dhënien e dekoratave dhe medaljeve, rrjedhimisht vlerësojmë se asaj (Kancelarisë) i korrespondon edhe një rol i mirëfilltë monitorues të zbatimit të projektaktit.

Përtej këtij niveli të parë, monitorimi i veprimtarisë së Kancelarisë do të bëhet nga strukturat më të larta, në aparatit shtetëror në varësi të Këshillit të Ministrave.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

**Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.**

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
<b>Kosto në total</b>										
<b>Kosto e zbritur në total =</b> Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
<b>Përfitimi në total</b>										
<b>Përfitimi i zbritur në total =</b> Përfitimi në total x faktorin zbritës										
<b>Vlera aktuale e kostos në total</b>										
<b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>										
<b>Vlera aktuale neto (VAN) =</b> Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

**Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni**

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**